

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.Nr.245/2020

Datë: 26 tetor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Shaban Zeqiraj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/11/GJTHPZ.nr.15/2019, të datës 09 mars 2020, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtareve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 26 tetor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Shaban Zeqiraj**, gjyqtar në Gjykatën e Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, **është** përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- II. Gjyqtarit Shaban Zeqiraj i shqiptohet sanksion disiplinor **Vërejtje publike me shkrim**.
- III. Gjyqtari Shaban Zeqiraj, **nuk është përgjegjës** për shkelje disiplinore të përcaktuar në nga neni 5, par. 2, pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Paneli Hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.252/2019, të datës 12 dhjetor 2019, për lëndën me numër Nr.AD/KGJK/11/GJTHPZ.nr.15/2019, të datës 09 mars 2020, i ka paraqitë Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen disiplinore të Shaban Zeqiraj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Suharekë.

Për të shqyrtuar këtë çështje, KGJK me 26 tetor 2020, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore ku morën pjesë kryesuesi i Panelit Hetimor gjyqtari Bekim Veliqi dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Shaban Zeqiraj.

Kryesuesi i Panelit Hetimor në fillim të seancës dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar se pas zhvillimit të hetimit ndaj gjyqtarit Shaban Zeqiraj dhe dëgjimit të tij, i cili hetim ishte iniciuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, sipas ankesës së avokates , është vërtetuar se gjyqtari Zeqiraj për lëndën C.nr.235/2016, është vonuar në përpilimin e aktgjykimit në afat prej 8 (tetë) muajve, ndonëse me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka qenë i obliguar ta përpiloj në afat prej 15 ditësh, veprim i cili përbën shkelje disiplinore të

përcaktuar më nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve.

Subjekti i hetimit Shaban Zeqiraj në seancën dëgjimore, ka deklaruar se është e vërtetë se i njëjti nuk e ka përpiluar aktgjykimin në lëndën C.nr.235/2016 në afat prej 8 muajve, por një e tillë ka ndodhur për shkak se kjo lëndë ka qenë me objekt kontesti vërtetim pronësie ndërsa lëndë tjetër C.nr.419/2016, ka qenë dorëzim i paluajtshmërisë, andaj për shkak të respektimit të parimit të ekonomizimit, ashtu që mos të dilet dy here në terren me ekspertin gjeodet për të njëjtën çështje, duke krijuar shpenzime, ka ardhur në atë situatë me pajtimin palëve që nuk ka mundur të nxjerr aktgjykimin sepse të gjitha provat është dashur t'ia bashkëngjisë edhe lëndës tjetër.

Për të vërtetuar këtë çështje KGJK administroj këto prova: Raportin e panelit hetimor mbi faktet dhe provat e mbledhura të datës 09 mars 2020, dhe të gjithë provat e tjera të bashkëngjitura kësaj lëndë disiplinore, si dhe ka dëgjuar kryesuesin e Panelit Hetimor dhe gjyqtarit Shaban Zeqiraj.

Pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK vërtetoi këtë gjendje faktike: Shaban Zeqiraj, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, në lëndën civile C.nr. 235/2016, ka përfunduar seancën kryesore më datë 22.02.2019, aktgjykimin për të njëjtën çështje e përpilon me datë 06.11.2019, pra me vonesë prej 8 (tetë) muajve, edhe pse me Ligjin për Procedurë Kontestimore, gjegjësisht nenin 153, ka qenë i obliguar ta përpilojë në afat prej 15 ditësh, si dhe nuk e ka njoftuar kryetarin e gjykatës me kohë, për shkaqet e tejkalimit të tij.

Nuk ishte kontestues fakti se tani subjekti i hetimit gjyqtari Shaban Zeqiraj, nuk e kishte përpiluar brenda afatit ligjor aktgjykimin në lëndën C.nr.235/2016, e kjo u vërtetua nga provat e administruara dhe nga vet deklarimi i subjektit të hetimit.

Deklarimin e subjektit të hetimit, gjyqtarit Shaban Zeqiraj, se arsyeja e mos përpilimit me kohë të aktgjykimin në lëndën C.nr.235/2016, ka qenë respektimi i parimit të ekonomizimit dhe ndërlidhja e provave, sepse të gjitha provat është dashur t'ia bashkëngjisë edhe lëndës tjetër, ku palët ndërgjyqëse kanë qenë të njëjta, por në cilësi të ndryshme, mirëpo nuk ka mundur ti bashkojë për shkak se objekti i kontestit ka qenë i ndryshëm, KGJK e vlerësoj në kundërshtim me obligimet dhe përgjegjësitë e tij si gjyqtar.

Me këtë subjekti i hetimit ka bërë shkelje disiplinore nga neni 5, par, 2 pika 2.7, pasi që nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me kohë siç kërkohet me ligj.


KGJK, me kujdes analizoi se cila nga sanksionet disiplinore i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij disiplinore, dhe vlerësoj se sanksioni disiplinor Vërejtje publike me shkrim, është sanksioni më i përshtatshëm me të cilin do të arrihet përmirësimi i sjelljes së gjyqtarit dhe do të shërbej si preventiv për të ardhmen e tij.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të avokates lidhur me ofendimet dhe fyerjet e gjyqtarit Shaban Zeqiraj në drejtim të saj, KGJK, e mveshni konstatimin e panelit hetimor i cili në raportin e tij thekson se nuk mund të vërtetohet pretendimi i ankueses se ka pasur ofendime nga ana e gjyqtarit të çështjes, dhe kjo vërtetohet nga vet përmbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore të daljes në terren, të lëndës C.nr.419/2016, i datës 04.11.2018, faqe 1, ngase aty konstatohet se gjykata ka kërkuar nga i padituri se në çfarë cilësie e autorizon dhe pas deklarimit të të paditurit është marr aktvendimi me konstatimin se avokate e të paditurit do të jetë nga e po ashtu edhe në faqen e dytë të procesverbalit nuk ka pasur vërejtje, janë marrë te gjitha veprimet përkatëse ligjore, dhe procesverbali është nënshkruar nga palët, të autorizuarit e palëve, në mes tyre edhe si dhe gjyqtari, andaj edhe KGJK vendosi ta shpallë jo përgjegjës.

Nga sa u tha me lartë e konform nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të Ligjit nr.06/l-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.245/2020, datë: 26 tetor 2020

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Artan Sejrani, U.D. i Kryetarit në Gjykatën Themelore në Prizren;*
- *Shaban Zeqiraj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë;*
- *Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;*
- *Arkivit.*